



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 1038 Date 19.12.2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME
“ UJESJELLES - KANALIZIME ” DURRES SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 “ Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare” ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise “ Ujesjelles - Kanalizime ” Durres , sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 54.7 % nga Bashkia Durres, 3.6 % nga Bashkia Shijak, 2 % nga Bashkia Vore, 6.7 % nga Bashkia Sukth, 2.5 % nga Bashkia Manez, 4.6 % nga Komuna Thumane, 1 % nga Komuna Ishem, 4.5 % nga Komuna Xhafzotaj, 7.2 % nga Komuna Rrashbull, 4.3 % nga Komuna Katund i Ri, 2.2 % nga Komuna Bubq, 0.8 % nga Komuna Prere, 2.4 % nga Komuna Fush-Kuqe, 1.9 % nga Komuna Maminas dhe 1.6 % nga Komuna Gjepalaj, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore”.

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit” Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENC BULI

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: smalko@mete.gov.al
Internet: <http://www.mete.gov.al>



Tel: +355 4 228467
Tel: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052



ASAMBLEJA E AKSIONERËVE TË U.K.SH.A DURRËS

V E N D I M

Nr. 11 Datë 30/10/2015

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË NENIT 5 PIKA 2, NENIT 7 PIKA 2, 3, TE NENIT 26, PIKA 1, 2, TË STATUTIT TË SHOQERISË PAS KONFIGURIMIT TË AKSIONEVE BAZUAR NË LIGJIN 115/2014 “PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

Asambleja e Aksionarëve në mbledhjen e tij të datës 30.10.2015, pasi shqyrtoi kërkesen e bërë nga Shoqëria U.K.sh.a Durrës, si dhe referuar nenit 1, 2, 3 dhe 4 të ligjit nr 115/2014 “Per ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, neneve 135/2/b/g, 137 dhe 145 të Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, nenit 7 pika 2 dhe 3, 11/e, 14, 15 dhe 22 të Statutit të Shoqërisë.

V E N D O S I:

1. Konstituimin e Asamblese së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë U.K. Durrës sh.a sipas ligjit nr 115/2014 “Per ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ndryshimin e pikes 2 (dy) dhe 3 (tre) të nenit 7 të Statutit të Shoqërisë pas konfigurimit të aksioneve bazuar në ligjin 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në republikën e shqipërisë”.
3. Pas konfigurimit të aksioneve, Aksionarë të Shoqërisë do të jenë:
 - Bashkia Durrës mbjatese e 341.483,552 aksione, ose 76.4 %
 - Bashkia Shijak mbjatese e 51.848,288 aksione, ose 11.6 %
 - Bashkia Krujë mbjatese e 30.393,824 aksione, ose 6.8 %
 - Bashkia Vore mbjatese e 12.515,104 aksione, ose 2.8 %

- Bashkia Kurbin mbjatese e 10 727,23 aksione, ose 2.4%

4. Ndryshimin e pikes 2 te nenit 5 te Statutit te Shoqerise pas konstituimit te Asamblese se Pergjitheshme bazuar në ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrativo- territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" si me poshte:

"Shtrirja e veprimtarise apo zonat e mbulimit jane Bashkite: Durrës, Shijak, Vore, Kruje Kurbin"

5. Ndryshimin e pikes 1 dhe 2 te nenit 26 te Statutit te Shoqerise pas konstituimit te Asamblese se Pergjitheshme bazuar në ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrativo- territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" si me poshte:

pika 1/a "Aksionari mazhoritar zgjedh 3/4 e anetareve te Keshillit Mbikqyres"

pika 2 "Aksionaret me perqindje me te vogel se aksionari mazhoritar, kane te drejten e caktimit te nje anetari te vetem ne keshill per nje periudhe 1- vjeçare me rotacion. Rotacioni nis me anetarin qe gezon me shume aksione nen aksionarin mazhoritar. Ne rast se nje aksionar nuk propozon anetarin e tij ne keshill brenda 1 muaji nga çasti qe i lind e drejta, kjo e drejte i kalon aksionarit me perqindje kapitali me te ulet, e me radhe sipas sistemit te rotacionit. Ne kete rast vendimi i Asamblese percakton daten e fillimit dhe mbarimit te mandatit te anetarit te emeruar.

6. Ngarkohet Drejtori Shoqerise te beje aplikim prane Q.K.R, per regjistrimin e ndryshimit te aksioneve dhe aksionareve te Shoqerise sipas pjeseve takuese te mesiperme.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE TË U.K. DURRËS. SH.A

BASHKIA DURRËS

perfaqesuar

BASHKIA SHIJAK

perfaqesuar

BASHKIA KRUIJË

perfaqesuar

BASHKIA VORË

perfaqesuar

BASHKIA KURBIN

perfaqesuar

SEKRETARE